

## **RREGULLA TEKNIKE PER PRODHIMIN E MATERIALIT SHUMEZUES TE ÇERTIFIKUAR PER AGRUMET.**

---

- **1. Rregullat e ketij Aneksi zbatohen per çertifikimin e materialit shumezues per gjinite Citrus, Poncirus, Fortunella dhe te tjera gjini te fam. Aurantoidea si dhe hibridet e tyre.**
- **2. Repozitori vendoset prane Institucioneve kerkimore.**
- **3. Speciet e permendura ne kete Aneks mund te shumezohen me copa, fare ose nepermjet shartimit te bimeve te te njejtes kategori.**
- **4. Materiali qe nuk eshte konform kushteve te kerkuara nga kjo rregullore nxirret jashte procesit te çertifikimit .**

## Kontrollet shendetesore kryhen si me poshte:

---

. a ) Ne materialin parabaze dhe baze:

- Kontrollet shendetesore do te kryhen konform me protokollet per secilen specie. Certifikimi i materialit te prekur nga viroidet mund te behet per disa kultivare me vlere te larte te shartuar vetem mbi portokallin e eger per periudha te kufizuara deri sa ata te jene shendetesuar. Ky material mund t'u shperndahet fidanishteve duke specifikuar qe ai mund te shartohet vetem mbi portokallin e eger.
- Si per viroidet, çdo bime duhet te testohet çdo tre vjet; per viruset dhe agjentet e ngjashem me to bimet testohen çdo 6 vjet. Bimet duhet te jene te pastra prej simptomave te Deuterophoma tracheifila.

## b ) Ne bimet meme te certifikuara:

---

Menyrat e kontrollit jane:

- - vizuale: qe kryhen gjate periudhes kur semundjet japin shprehjen me te qarte simptomatologjike, perfshire "mal secco"
- - analiza laboratorike: vetem ne bimet meme, duke zbatuar protokollet perkatese.
- Cdo vit do te analizohen 10 per qind e bimeve, keshtu bimet do te analizohen nje here ne 10 vjet.
- 6. Kontrollat per vertetesine gjenetike kryhen si me poshte:
  - a ) Ne materialin parabaze dhe baze:

- 
- Çertifikimi per vertetesine varietore per kultivaret dhe
  - nenshartesat mund te leshohen vetem pasi te jete vrojtuar prodhimi ne vjelje per tre ciklet e fundit per te vleresuar vertetesine fenotipike te materialit.
  - Çertifikimi per vertetesine varietore te nenshartesave mund te leshohet pasi te kemi vrojtuar ciklin e plote te rritjes ne fidanishte te pakten te 200 filizave te ardhura nga fara.
  - Kontrollat per materialin parabaze dhe baze behen ne vende te autorizuarra Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit. Gjate 1-2 viteve te para do te behen te pakten 2 inspektime qe perseriten çdo vit gjate fazave *fenologjike* te lidhjes se frutave dhe pjekjes se tyre.

## b ) Ne bimet meme te çertifikuara

---

- Para marrjes se materialit te çertifikuar vertetesia varietore duhet te vleresohet per te gjitha bimet çdo vit.
- 7. Karakteristikat teknike qe duhet te permbushin pemetoret meme dhe Fidanishtet me bime te çertifikueshme;

## 7. Karakteristikat teknike qe duhet te permbushin pemetoret meme dhe Fidanishtet me bime te çertifikueshme jane si me poshte

---

- a ) Pemetoret meme te kultivareve dhe te nenshartesave duhet te permbushin keto kushte:
- - Pemetorja duhet te vendoset ne kushte tokesore te mira ku nuk jane mbjelle specie te agrumeve te pakten per 5 vjet, e paster nga shtamet virulente dhe nga nematoda *Pratylenchus vulnus*. Numuri i *Tylenchulus semipenetrans* ne toke nuk duhet te kaloje 4 larva per gram toke dhe 100 femra per gram rrenje.
- *Phytophthora* spp. nuk duhet te kaloje 3 spore per gram toke te thate.
- Bimet meme te limonit duhet te vendosen ne toka ku te pakten per 5 vjet nuk jane mbjelle me te njejten specie.

- - Fusha duhet te vendoset 100 metra nga çdo agrumishte. Bimet e limonit duhet te mbuloohen me nje rrjete 50 % te bardhe per te parandaluar infeksionet nga "mal secco".
- - Parcelat brenda pemetores duhet te jene homogjene, te identifikohen me lehtesi dhe te jene te destinuara per t'u mbjelle vetem me bime meme;
- - Ne parcele rreshtat duhet te jene te dallueshem sipas specieve. Kur kultivare te ndryshem jane te mbjelle ne te njejtin rresht, ato duhet te jene jo me pak se 8 metra larg;
- - Parcelat duhet te kene zone mbrojtese te pakten 3 metra, si dhe 9 metra larg mbetjeve bimore te bimeve parardhese, e punuar vazhdimisht dhe e paster nga te gjitha tippet e tjera te vegjetacionit.

- 
- - Blloqet meme nuk mund te mbahen per marrjen e sythave me shume se 30 vjet. Ndersa pemet meme per fare (per prodhimin e nenshartesave) ky limit eshte 40 vjet;
  - - .Nga çdo peme per sytha nuk duhet te merren me teper se 1 mije lastare per te siguruar nje numur prej 4 mije sythash;
  - - Ato duhet te mbrohen mire nga semundjet dhe demtuesit e ndryshem.



## b ) Blloqet e rritjes duhet te permbushin keto kushte:

---

- agrumishtet. Nenshartesat dhe lastaret e te njejtës kategori, duhet te kene nje kercell te trashe 0.7-0.9 cm diametric.
- Densiteti i bimeve nuk duhet te kaloje 8 bime per m<sup>2</sup> dhe vazot duhet te kene nje kapacitet te pakten 8 litra.
- Vazot mbushen me dhe qe ka te njejtat karakteristika me ato te fushes se bllokut meme dhe vendosen mbi nje siperfaqe te mulçeruar ose jo.
- Per çdo lloj prerje kerkohet dezinfektimi i veglave te punes me solucion 10 per qind hipoklorit sode.
- Parcelat duhet te jene relativisht homogjene per kultivarin ose klonin, te dallueshme mire dhe lehtesisht te identifikueshme permes nje kodi.
- Mbishartesat duhet te perseriten me material te te njejtës kategori.
- Demtuesit dhe semundjet duhet te kontrollohen vazhdimisht.

c ) Fidanishtet me bime te çertifikueshme duhet te permbushin kerkesat e meposhtme:

■ **Farishtja:**

- - perdoret fare e çertifikuar nga pikpamja gjenetike dhe sanitare.
- - ngastrat homologe duhet te permbajne te pakten 500 fidana ne fushe dhe/ose vazo 8 litershe ( 16x 45 cm ose 18 x 40 cm). Toka dhe/ose dherishtja duhet te jene te pastra nga nematodat dhe kerpudhat demtuese te agrumeve.
- - toka duhet te jete plotesisht me karakteristika te njejta me bllokun meme.
- - bimezat qe transferohen ne fole duhet te kene karakteristikat e te njejtit lloj dhe nje minimum gjatesie prej 30 cm; diameter te kercellit prane kurores 0.5 cm.
- - farishtja duhet te jete e paster te pakten 15 meter larg agrumishteve me material shumezues te paçertifikuar.

## *Shtrati i mbjelljes:*

---

- - toka duhet te plotesoje kushtet siç pershkruhen tek Pemetorje meme. Fidanet e specieve te ndjeshme ndaj "mal seccos" duhet te vendosen nen rrjete te bardhe kur jane me pak se 50 metra larg plantacioneve me limona.
- - ato duhet te jene te ndara ne parcela homologe sipas nenshartesave, te dallueshme mire; ço rresht i parces duhet te kete te njejtin kultivar ose klon; distanca e mbjelljes duhet te jete 20 cm ne rrjesht dhe 30 cm midis rreshtave kur jane mbjelle direkt ne toke; vazot 8 litershe duhet te vendosen 20 cm ne rresht dhe 50 cm midis ngastrave me 4 rreshta.
- Bimezat per t'u shartuar duhet te kene nje diameter minimumi 0.8 cm i matur ne nivelin e pikes se shartimit 40 cm nga kurora. Lastaret per shartim duhet te merren ne blloqet meme ose blloqet e rritjes te autorizuara. Mbishartesat duhet te jene nga material i te njejtin kultivar dhe kategorie shendetsore; ne nje rast te tille shartimi tolerohet ne 35 cm nga kurora.

- 
- - Ngastra duhet te jete e kufizuar nga nje brez prej te pakten 2 m i paster prej çdo vegjetacioni.
  - - ngastra duhet te jete te pakten 15 meter larg nga agrumishtet ose fidanishtet e fituara nga material shumezues te pakualifikuar.
  - - shtreterit e mbjelljes se limonit duhet te vendosen nen rrjeta 50 % per t'i ndare nga blloqet e limonit ne prodhim;
  - - parcelat duhet te paraqiten ne nje planimetri te veçante; -
  - - patogjenet dhe demtuesit duhet te luftohen me kujdes. - çdo prerje duhet bere me paisje te dezinfektuara me solucion hipoklorit sode 10 %;

## 8. Analizat Nematologjike te tokes dhe te bimeve ne

### Bloqet meme dhe ne Fidanishte kryhen si me poshte:

- Toka ku materiali i çertifikuar eshte rritur, duhet te analizohet dhe te rezultojte e paster nga *Tylenchulus semipenetrans*, *Pratylenchus vulnus*.
- Si per bloqet meme, tolerohet per 4 larva per gram toke te *Tylenchulus semipenetrans* dhe 100 femra per gram rrenje.
- Mostrat duhet te merren ne pranvere dhe vjeshte para kultivimit.
- Duhet te merren 10 kampione per hektare, sejcila prej tyre nga jo me pak se 5 nenkampione te ndryshme.
- Mostrat dergohen ne nje laborator te autorizuar nga Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit. Nese nga analizat e kryera rezulton prani e nematodave te mesiperme atehere;
- toka duhet te dezinfektohet duke ndjekur udhezimet laboratorike.
- Efikasiteti i trajtimit duhet te konfirmohet nga nje analize tjeter qe behet 6 muaj pas ketij trajtimi.

9. Analizat e tokes per phytophthora spp. ne blloqet meme dhe fidanishte kryhen si me poshte:

---

- Toka ku materiali i çertifikuar eshte kultivuar duhet analizuar per t'u siguruar qe sasia e Phytophthora spp. nuk duhet te kaloje 3 spore per gram toke te thate.
- Mostrat duhen marre ne pranvere para mbjelljes.
- Duhen marre 20 mostra per hektare, sejcila e veçuar prej 10 kampioneve.
- Duhen bere inspektime periodike per te kontrolluar çdo lloj kontaminimi.

10. Elementet kryesore biometrike dhe cilesore te materialit qe do te certifikohet ne fidanishte jane si me poshte:

■ ***Nenshartesat:***

- - gjatesia minimale nga kurora 30 cm; -diametri minimal ne kurore 0.5 cm;

■ ***Lastaret:***

- - te drunjezuar mire, gjatesia e te cilave korrespondon me prezencen e 4 sythave; ne rastin e kalemave diametri i tyre duhet te jete me i vogel se 0.5 cm.

■ ***Bimet e shartuara:***

- - pika e shartimit 4 cm nga kurora, minimumi i zhvillimit te lastareve te jete 50 cm per bimet ne fushe te hapur dhe 30 cm per bimet ne vazo.

# PROTOKOLL PER VLERESIMII~ E GJENDJES SHENDETESORE TE AGRUMEVE DHE TE NENSHARTESAVE QE LIDHEN ME TE PER

## ÇERTIFIKIMIN "PA VIRUSE

Emertimi ne anglisht Analiza	Shkaktari	Indicatori	
■ <b>1. Viruse.</b>			
■ Tristeza ELISA dsRNA Vein enation ELISA	CTV CVEV	Mex. lime Mex. lime	
■ Variegation ELISA	CVV	Lemon or Etrog citron 861 SI	
■ Crinkly leaf	CCL V	Lemon or Etrog citron 861 SI	
■ Psorosis	CPs V	Pineapple orange, Hamllin navelina	
■ Ring spot	CRSV	Grapefruit or Etrog citron 861 SI	
■ Kumquat disease	KdV	Troyer citrange	
■ Mosaic ELISA Satsuma dwarf	CiMV CTL V	Dweet tangor Citrange	ELISA
■ Tatter leaf ELISA	CTL V	Citrange	



## *2. Viroide.*

### ■ **2. Viroide.**

- |                             |         |                      |
|-----------------------------|---------|----------------------|
| ■ Exocortis<br>dPAGE        | CEV d   | Etrog citron, 861 SI |
| ■ Cachexia<br>dPAGE         | CCa V d | Parsons, mandarin    |
| ■ Te tjera viroide<br>dPAGE | CV d    | Etrog citron, 861 SI |

### ■ **3. Virus-like diseases.**

- |                                  |     |                   |
|----------------------------------|-----|-------------------|
| ■ Concave gum                    | CG  | Pineapple, orange |
| ■ Cristacortis                   | CCr | Pineapple, orange |
| ■ Impietratura                   | CI  | Grapefruit        |
| ■ Rough lemon<br>incompatibility |     | Rough lemon       |

### ■ **4. Spiroplasm.**

- |                     |                    |           |
|---------------------|--------------------|-----------|
| ■ Stubborn<br>ELISA | <i>Spiroplasma</i> | Pineapple |
| ■                   | <i>Citri</i>       | orange    |

**PROTOKOLL PER DREJTIMIN E PRODHIMIT DHE SHPERNDARJEN E MATERIALIT SHUMEZUES NE AGRUME -NGA BURIMI PRIMAR -I**

**PRODHUAR NE BLOQET E RRRITJES.**

---

- **Kushtet e prodhimit**
- **a) Materiali shumezues (lastare ose sytha) duhet marre nga bime te individualizuara sipas protokollit.**
- **b) Shoqerite e fidanishteve bien dakort per te rritur fidana ne fitocella prej 16/45 cm ose 18/40 cm te vendosura ne distance te pakten 15x20 cm ose 22x22cm ne tunele te mbuluara me rrjete**

- **c)Fidanat ne blloqet e rritjes duhet te kene nje diameter minimumi 1 cm, 40 cm nga kurora.**
- **Perqindja e bimeve qe eleminohen mund te arrije 10 %. Shartimi behet 40 cm nga toka. ,**
- **e)Periudha e shartimit shkon nga 1 prilli deri me 10 qershor per shartimin me sytha ose kurore vegjetative dhe nga 15 gushti deri ne tetor per sytha te fjetur.**
- **f)Operacionet e pastrimit te degeve anesore dhe te thithakeve suplementare duhet bere me mjete (gershere, thika etj. ) te dezinfektuara me solucion 10% hipoklorit sode.**

- **g) Parcelat homologe ose ngastrat duhet te kufizohen me shenja te ngjyrosura ku nje kod ngjyre te tregoje kultivarin ose klonin, sipas nje kodi ngjyre te vene ne tabelen A, e percaktuar nga nje liste qe jep nenshartesen, emrin e kultivarit, klonin daten e shartimit, numurin e bimeve te shartuara qe kane zene. Pas zenies se shartimit, numuri i bimeve te shartuara duhet te behet i ditur per cdo parcele ose ngaster.**
- **h) Ne rastin e mbisharteses ne nje parcele ose ngaster homologe te vecante , nuk lejohet te perdoret material tjeter pervec atij te perdorur ne shartimin e pare. Shartimi tjeter lejohet 30 dite pas shartimit te pare dhe ne cdo rast jo me vone se ne qershor.**
- **Behet luftimi sistematik i patogjeneve.**

## Menyrat e grumbullimit ruajtjes dhe shperndarjes

---

- a) Sasia e materialit shumezues qe do te merret percaktohet ne baze te kerkesave teknike.
  
- b) Lastaret duhet te mbajne te pakten 4 sytha te seleksionuar ne perputhje me llojin, ato ruhen ne qese polietileni (35x65 cm; 0.10 mm te trasha),

- 
- e) Qeset ku vendosen lastaret per fidanishtet duhet te kene nje etikete me emrin dhe/ose kodin e prodhuesit dhe gjendjen e lastareve.
  - f ) Perpara shperndarjes se materialit shumezues ne fidanishte, komisioni pas ekzaminimit te aplikimeve i vlereson lastaret, sipas standartit kombetar
  - g) Mbas vleresimit te lastareve, fidanishtet duhet te bejne te njohur listen e fidanave qe levrohen.
  - L) Nje fidan duhet te kete 3 dege kryesore mbi nje aks. Prerja e ketyre degeve lejohet nese gjatesia minimale e tyre i kalon 20 cm.

- 
- c) Qeset me lastare duhen mbajtur ne temperature 10-15 o C nese transferohen nga blloqet e rritjes (fidanishtet) ne qendrat e grumbullimit (vazo te izoluara) dhe ndahen n~ para shperndarjes se tyre ne fidanishtet.
  - d) Nese mbajtja e tyre ne depo kalon 10-15 dite, qeset duhet te pastrohen dhe kontrollohen cdo jave per sythat e demtuar.
  - e) Perpara shperndarjes se materialit shumezues ne fidanishtet e zakonshme, komisioni pas ekzaminimit te aplikimeve i vlereson lastaret te nivelit kombetar.
  - 7
  - f) Mbas vleresimit te lastareve, ~h~ e fidanishteve duhet te bejne te njohur listen e fidanave~e levrohen.
  - g) Qeset ku vendosen lastaret per fidanishtet e zakonshme do te kene nje etikete me emrin dhe/ose kodin e prodhuesit dhe gjendjen e lastareve.